



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 93, datë 13.06.2018

PËR
MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE KORPUSIT VULLNETAR TË SHËRBIMEVE
FINANCIARE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 18, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Kërkimeve dhe Zhvillimeve Strategjike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e Memorandunit të Mirëkuptimit ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare, sipas tekstit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Kërkimeve dhe Zhvillimeve Strategjike për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ky dokument paraqet një Memorandum Mirëkuptimi (MM) midis **Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC)**, me seli në New York, SHBA dhe **Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF)**, me seli në Tiranë, Shqipëri. Secila nga palët e përmendura më sipër bien dakord me sa vijon:

I. Qëllimi i MM-së

FSVC dhe AMF (në vijim referuar individualisht dhe kolektivisht si "Palët") kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale të AMF-së, përmes një sërë misionesh të asistencës teknike të financuara nëpërmjet një granti të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Palët përpiqen të shfrytëzojnë përvojën e rëndësishme që FSVC ka në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit dhe programeve të asistencës teknike për të mbështetur AMF-në përmes një programi të përshtatur direkt me nevojat specifike të AMF-së dhe në përputhje me objektivat e zhvillimit të USAID-it për Shqipërinë. Këto konsultime të personalizuara, trajnime në vendin e punës dhe workshope do të ofrohen nga profesionistë me përvojë në sektorët financiarë dhe ligjorë të SHBA-së dhe/ose tregje të tjera të zhvilluara dhe do të hartohen për të ndërtuar dhe mbështetur trajnimet e mëparshme dhe shërbimet e këshillimeve teknike të marra nga institucionet e tjera.

Qëllimi i këtij Memorandumi është të përcaktojë dakordësimet dhe synimet e palëve në lidhje me këto objektiva të përbashkëta. Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk do të interpretohet si mbivendosje ose ndërhyrje nëpërmjet marrëveshjeve apo kontratave të lidhura midis dy ose më shumë palëve të tjera, qoftë para ose pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

II. Shërbimet që do të ofrohen nga FSVC

Në mënyrë që të ndihmojë AMF-në në përpjekjet e saj për të forcuar kapacitetet institucionale, kryesisht në fushat e mbikëqyrjes së tregjeve të sigurimeve, fondeve të investimeve dhe pensioneve dhe stabilitetit financiar, FSVC do të organizojë një sërë aktivitete të asistencës teknike, duke filluar me nënshkrimin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit dhe përfundimin e tij më 31 dhjetor 2019. Temat dhe sesionet e aktiviteteve mund të ndryshojnë për të pasqyruar prioritetet e menaxhimit të AMF-së kohë pas kohe. Temat dhe datat e shërbimeve së bashku do të përshkruhen në një plan pune të miratuar me shkrim nga FSVC dhe AMF.

Në ofrimin e këtyre shërbimeve, parashikohet që FSVC të ndërveprojë me stafe të sktrukurave të ndryshme të AMF-së. Për të siguruar shpërndarje efektive të shërbimeve, përfaqësuesit e caktuar nga FSVC dhe AMF do të realizojnë komunikimin brenda afatit të përcaktuar. Palët bien dakord t'i përgjigjen pyetjeve dhe kërkesave për informacion brenda dy javëve.

III. Kontributet

Sipas nevojës, AMF do të kontribuojë me ambientet e zyrave për ekspertët e FSVC-së, ambientet për aktivitete e trajnime, mbulimin e shpenzimeve për printimin e materialeve që do të përdoren gjatë misioneve të asistencës teknike dhe shpenzimet e përgjithshme të lidhura me zbatimin e programit. Çdo donacion do të konsiderohet "ndarje e kostove" përtej buxhetit të përcaktuar për mbështetjen e aktiviteteve të programit. Një formular verifikimi lidhur me ndarjen e kostove do të plotësohet dhe nënshkruhet nga AMF në fund të çdo aktiviteti të asistencës teknike.

IV. Marrëdhëniet midis Palëve

Palët nuk janë të angazhuara në një marrëdhënie punëmarrës-punëdhënës, sipërmarrje të përbashkët ose marrëdhënie agjencie të çdo lloji, dhe as nuk kanë për qëllim krijimin e një subjekti juridik. Asnjëra palë nuk ka autoritet të shprehë ose të nënkuptojë krijimin e ndonjë detyrimi financiar ose ndonjë detyrim tjetër në emër të ndonjë pale tjetër. Asnjëra palë nuk do të ndërmarrë ndonjë angazhim ose të marrë pozicion në emër të ndonjë pale tjetër pa pëlqimin me shkrim specifik të organizatës. Asnjëra palë nuk do të përdorë simbolin e palës tjetër, duke përfshirë këtu emrin ose logon e asaj pale, pa pëlqimin me shkrim paraprak të palës specifike.

V. Zbatimi

FSVC do të jetë përgjegjëse për hartimin, koordinimin, menaxhimin dhe monitorimin e përgjithshëm të aktivitetit të programit. Programi ka një periudhë veprimtarie që fillon me nënshkrimin e këtij dokumenti nga të dy palët dhe përfundon më 31 dhjetor 2019.

VI. Ndryshimet në MM dhe/ose Fushëveprimi

Në rast se AMF kërkon një ndryshim në fushën e veprimit të programit të asistencës teknike, FSVC ka të drejtë të rivlerësojë dhe të hartojë një plan të ri pune, i cili pasqyron kërkesat e fushëveprimit të ri të rishikuar. FSVC kërkon të njoftohet minimalisht dy muaj përpara për të siguruar cilësinë e aktiviteteve dhe shërbimeve që do t'i ofrohen AMF-së. Ndryshimet brenda fushës së shërbimeve do të bëhen vetëm me shkrim, të realizuara nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy palëve.

VII. Ngjarjet për shkak të forcës madhore

FSVC dhe AMF do të përjashtohen nga përgjegjësia për mospërbushje të pjesshme ose të plotë të detyrimeve sipas këtij memorandum mirëkuptimi, nëse kjo mospërbushje vjen si rezultat i ngjarjeve për shkak të një force madhore, e cila mund të ndodhë pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit si rezultat i dukurive të jashtëzakonshme që palët nuk mund të

parashikojnë ose të parandalojnë përdorimin e masave të arsyeshme. Ngjarjet për shkak të forcës madhore do të përfshijnë ngjarje përtej kontrollit të Palëve dhe për dukurinë e të cilës palët nuk janë përgjegjëse, si p.sh. tërmeti, përmbytja, zjarri, greva, dekretet e qeverisë ose konflikte të çdo lloji që pengon përbushjen e detyrimeve të kësaj marrëveshjeje. Pala që përfshihet në rrethana të forcës madhore duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër me shkrim, duke bashkëngjitur dokumentet e lëshuara nga agjencitë e autorizuara të vendit përkatës dhe duke konfirmuar dukurinë dhe ndërprerjen e ngjarjeve të forcës madhore.

VIII. Data e hyrjes në fuqi

MM e nënshkruar do të hyjë në fuqi menjëherë.

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët, secila prej tyre duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë të mundur nënshkrimin e kësaj MM në emër të tyre dhe dorëzimin e saj në datat e përcaktuara sa më poshtë.

John Pompay
Drejtues Financiar dhe Operativ
Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare

Data

Ervin Koçi
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Data